



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E PERGJITHSHME E PLANIFIKIMIT STRATEGJIK
PER MINIERAT DHE INDUSTRIE
DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TE MINIERAVE

Nr. 2086

Tirane, date 23.1.2015

Drejtuar: Shoqëria "Albsoni" Shpk
Rruga Shengjun, Pall.3, Shk.2, Klos

BURREL

Për dijeni: Shoqëria "Krasta" shpk
Banese 2 Kat. Kraste, Martanesh

BULQIZE

Lënda: Njoftim mbi fillimin e procedurave për ndryshimin e koordinatave të lejes minerare nr.1259/2, datë 21.05.2014

I nderuar Z. Osmani,

Shoqëria "Albsoni" shpk është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1259/2, date 21.05.2014, për shfrytëzimin e mineralit të Nikelit sulfur dhe kromit në objektin Kraste, Qarkun Dibër.

Në zbatim të nenit 47, pika a1, të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, "Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me kërkesë të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë (MEI), struktura përgjegjëse, AKBN me shkresën nr.2200/1, date 16.02.2014 ka dërguar dokumentacionin e verifikimeve të mbivendosjeve të lejeve minerare në zonën e Bulqizës, si dhe ka propozuar ndryshimet që duhen bërë në koordinatat e lejes tuaj nr.1259/2, datë 21.05.2014, për të shmangur mbivendosjen me lejen minerare nr.858, datë 12.05.2005.

Koordinatat dhe sipërfaqja e zonës minerare e cilat do të hiqet nga sipërfaqja e miratuar e lejes minerare nr.1259/2, datë 21.05.2014, është si me poshtë:

Koordinatat e zonës minerare e cila
do të hiqet nga sipërfaqja e lejes
minerare nr.1259/2

Nr	Koordinatat	
	Y	X
1	44 34 600	45 88 445
2	44 34 600	45 88 529
3	44 34 532	45 88 546
4	44 34 4563	45 88 513
Sipërfaqja 0.0045 km ²		

Sa me sipër, në zbatim të nenit 47, pika a1, të ligjit nr.10304, datë 22.06.2012, "Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ju njoftojmë se ka filluar procedura e ndryshimit të koordinatave të lejes minerare nr.1259/2, datë 21.05.2014, për të shmangur mbivendosjen si me sipër.

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim do të merret vendimi për ndryshimin e koordinatave të lejes minerare si me sipër.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

